REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit 02
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 05-10168
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages -4-
Data: / Datum: / Date: 26/12/2024
Prishtinë / a

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosova**
*Qeveria – Vlada - Government*
*Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva*

# PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: SKRININGU NEONATAL

PËRMBAJTJA: PËRSHKRIMI I PROCEDURAVE NË PROCESIN E SKRININGUT NEONATAL TË TË PORSALINDURVE

VERSIONI:[1.0]
DATA E APROVIMIT [24/12/2024]
AUTOR [GP/MSh/ShSKUK]
NR. I HAPAVE [VI]
NR. I NËNHAPAVE [26]

APROVUAR: Dr. Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm, MSh

V.V

| | |
|---|---|
| QËLLIMI | KJO PROCEDURË KA PËR QËLLIM TË PËRSHKRUAJ HAPAT E MARRJES SË GJAKUT TE ÇDO I PORSALINDUR, GRUMBULLIMIN E MOSTRAVE, TRANSPORTIN E TYRE DERI NË LABORATOR (QKUK/KLINIKA E NEONATOLOGJISË), ANALIZËN LABORATORIKE TË TYRE DHE RAPORTIMIN E REZULTATEVE TË FITUARA PËR HIPOTIREOZË, FENILKETONURI, FIBROZË CISTIKE DHE GALAKTOZEMI. |
| NDËRLIDHJA ME AKTET | • LIGJI NR 04/L125 PËR SHËNDETËSI<br>• PROGRAMI PËR SKRININGUN NEONATAL - PLANI I VEPRIMIT 2023-2025<br>• STRATEGJIA PËR SHËNDETIN E NËNËS, FËMIJËS DHE SHËNDETIN RIPRODHUES, PV 2023-2025 |
| LISTA E SHKURTESAVE | QKUK – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS<br>KOGJ – KLINIKA GJINEKOLOGJIKE OBSTETRIKE<br>KPSH – KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR<br>SISH – SISTEMIT INFORMATIV SHËNDETËSOR |

## PROCEDURA

| Nr. | HAPI | NËN-HAPAT |
| --- | --- | --- |
| I | Marrja e gjakut për analizë | 1. Gjaku për skrining neonatal duhet të merret 24-48 orët e para të jetës së të porsalindurit;<br>2. Përgatitet materiali i nevojshëm si:<br>a. dorëza sterile;<br>b. alkool 70%;<br>c. lanceta sterile;<br>d. gaza të thata sterile;<br>e. test filtër;<br>f. zarfi.<br>3. Sigurohu që të gjitha materialet të jenë sterile dhe gati për përdorim. |
| II | Proceduara e marrjes së gjakut për analizë | 1. Paraprakisht plotësohen të dhënat në letrën e test filtër;<br>2. Vendosen dorëzat sterile;<br>3. Thembra e të porsalinduri pastrohet me alkool 70%; <br>4. Punktohet me lancetë sterile (shih foto);<br>5. Pika e parë e gjakut pastrohet me gazë të thatë sterile;<br>6. Gjaku merret nga thembra me letër filtër;<br>7. Mostra e gjakut duhet të qëndroi së paku dy orë në ambient dhome pa ekspozim direkt në dritën e diellit;<br>8. Mostra e tharë e gjakut në letër filtër vendoset në zarf. |
| III | Grumbullimi dhe transportimi i mostrave | 1. Mostra e tharë e gjakut në letër filtri e vendosur në zarf dërgohet në laboratorin e Skriningut të të porsalindurve brenda 48 orëve;<br>2. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohen të dhënat e institucionit që e dërgon mostrën;<br>3. Zarfi i mbyllur vendoset në kuti transporti dhe dërgohet në Laborator në Kliniken e Neonatologjisë/KOGJ;<br>4. Mostrat nga Maternitetet e KPSh-së duhet të dërgohen në spitalin e përgjithshëm më të afërt brenda 24 orëve ku grumbullohen me mostrat tjera nga spitali;<br>5. Mostrat nga spitali dhe KOGJ dërgohen në Laborator në Kliniken e Neonatologjisë/KOGJ;<br>6. Mostrat nga institiucionet private dërgohen direkt në Laborator në Klinikën e Neonatologjise/KOGJ. |

| | | |
|---|---|---|
| IV | Pranim/<br>Dorëzimi i mostrave dhe përpunimi /analiza e mostrave | 1. Mostrat nga tereni pranohen në laborator nga tekniku laborant përgjegjës, i cili i evidenton mostrat e pranuara;<br>2. Pas pranimit të mostrave stafi i laboratorit ndjek procedurat profesionale për përpunimin dhe analizën e mostrave për skriningun neonatal. |
| V | Përpunimi dhe njoftimi i rezultateve | 1. Rezultatet interpretohen nga profesionistët / Biokimisti në laborator dhe evidentohen;<br>2. Rezultatet evidentohen edhe në databazë për skrining neonatal;<br>3. Për rezultatet pozitive (të dyshimta) për patologji përkatëse duhet të njoftohen institucionet nga të cilat është pranuar mostra e gjakut,; përmes postës elektonike;<br>4. Institucioni përkatës (Materniteti, Spitali i Përgjithshëm, Klinika e Neonatologjisë dhe institucioni privat) obligohet të njoftoi prindin, bazuar në të dhënat e plotësuara paraprakisht në mostren e marrë (përmes telefonit, adresës elektronike etj.;<br>5. Profesionisti shëndetësor në institucion (pediatri) pas vizitës mjekësore dhe konsultimit njofton prindin për rezultatin e dyshimtë dhe e udhëzon për hapat e mëtutjeshëm;<br>6. Rastet e dyshimta referohen për trajtim të mëtutjeshëm (analiza shtesë për konfirmin të diagnozës apo rezultati eventual rrejshëm pozitiv) te specialisti përkatës në QKUK. |
| VI | Databaza/<br>raportimi | 1. Databaza e të gjitha rasteve të përfshira në skrining neontal përgatitet nga Dep.i SISh-it dhe siguron qasje në këtë databazë për të gjitha institucionet ku ndodhin lindjet. |